



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT

PËR

MONITORIMIN E PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT NË

MINISTRINË E BRENDSHME

Tiranë, Shtator 2018

RAPORT

Për përmbylljen e procesit të monitorimit në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të ristrukturimit, në Ministrinë e Brendshme

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet urdhrin nr. 85, datë 9.10.2017, “Për fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave në lidhje me procesin e riorganizimit të institucioneve të administratës shtetërore (mbylljes dhe ristrukturimit), pas miratimit të përbërjes së Këshillit të Ministrave”, ka vendosur fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit të aparatit të Këshillit të Ministrave dhe Ministrive të linjës.

Bazuar në pikën 4, të tabelës nr. 1, bashkëlidhur urdhrin më sipër, u ngrit grupi i punës me përbërje inspektorët, Behare Hoxha dhe Saimir Muçmataj, të cilët janë autorizuar nga Komisioneri për të monitoruar procesin e ristrukturimit në Ministrinë e Brendshme, i cili filloi në datën 5.2.2018.

Objekti i monitorimit në këtë institucion është procedura e ristrukturimit, që përfshin të gjitha proceset e legjislationit për nëpunësin civil, që rregullojnë këtë aspekt, ndër të cilat përmendim, hartimin e përshkrimeve të reja të punës; krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; veprimtaria e Komisionit të Ristrukturimit, aktet administrative për propozimin e transferimeve të Komisionit të Ristrukturimit; verifikimi i propozimeve për sistemimin e nëpunësve dhe miratimi i tyre nga Departamenti i Administratës Publike; evidentimi i rasteve të lirimit nga shërbimi civil, respektimi i afateve procedurale nga ana e aktorëve që marrin pjesë në këtë procedurë, etj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës përpunoi të dhënat dhe përgatiti raportin e monitorimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit në Ministrinë e Brendshme, si më poshtë:

Qëllimi i monitorimit

Qëllimi i realizimit të këtij procesi është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin

dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

- Paraqitja e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil para përgjegjësve për administrimin e procesit të ristrukturimit.
- Paralajmërimin e njësisë përgjegjëse, institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Metodologjia e monitorimit

Si metodë pune është përdorur verifikimi i dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në sektorin e Burimeve Njerëzore të institucionit, si dhe Departamentit të Administratës Publike. Konkretisht, grupi i punës realizoi veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u organizua një takim dhe bashkëbisedim, në datën 5.2.2018, me Përgjegjësen e Sektorit të Burimeve Njerëzore, me të cilin u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e procesit, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të punës për verifikim. Person i kontaktit me grupin e punës në këtë institucion, u caktua nëpunësja ******, e cila kryen detyrën Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore.
- U administrua gjithë dokumentacioni shkresor i konsideruar i nevojshëm për realizimin e këtij monitorimi, e konkretisht: struktura aktuale dhe struktura mëparshme; listë prezencat para dhe pas ristrukturimit; disa modele të formatit të përkimeve të punës; dokumentacioni që materializon procedurën e ristrukturimit; aktet administrative që materializojnë vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe të Departamentit të Administratës Publike; si dhe çdo dokumentacion tjetër që ndihmon realizimin e verifikimit të procesit.

Përmbajtja e Raportit:

Me miratimin e përbërjes së Këshillit të Ministrave, që përkon me mbarimin e procesit zgjedhor të vitit 2017, rezulton se është riorganizuar i gjithë aparati shtetëror. Nga ky proces, u shkrinë 8 ministri të mëparshme, funksionet e të cilave iu bashkuan 11 ministrive të mbetura, si dhe u shtuan 2 ministri të reja, duke e reduktuar numrin nga 19 ministri, që ishin para zgjedhjeve, në 13 ministri.

Për pasojë, Ministria e Brendshme, e cila është subjekt i këtij monitorimi, si dhe gjithë ministrinë e tjera, kaluan në proces ristrukturimi.

Në përfundim të procesit të monitorimit rezultoi si më poshtë:

I. *Procesi i riorganizimit e ristrukturimit të aparatit të Ministrisë së Brendshme*

Kriteret bazë mbi të cilat është bërë vlerësimi i ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, lidhur me tërësinë e veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse DAP, Komisioni i Ristrukturimit i Ministrisë së Brendshme, Sekretari i Përgjithshëm dhe njësia e burimeve njerëzore e aparatit të Ministrisë së Brendshme, (*që është institucioni i cili iu nënshtrua procesit të riorganizimit e ristrukturimit*), janë kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar si dhe udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016 të Departamentit të Administratës Publike “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, i ndryshuar.

Duke trajtuar dokumentacionin e vënë në dispozicion, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga komisioni i ristrukturimit, krijimin, funksionimin dhe ushtrimin e kompetencave të tij, konstatojmë si më poshtë:

I.a Struktura organizative e Ministrisë së Brendshme para dhe pas procesit të ristrukturimit

Emërtesa e këtij institucioni “*Ministria e Brendshme*” është miratuar me Dekret të Presidentit të Republikës nr. 10604, datë 10.9.2017 “*Për emërimin e Këshillit të Ministrave*”. Me vendimin nr. 502, datë 13.9.2017 të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme*”, është përcaktuar fusha e veprimtarisë shtetërore si dhe përgjegjësitë e kësaj ministrie. Më pas, me urdhrin nr. 162, datë 5.10.2017 të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme*”, është miratuar struktura e organizimit të brendshëm e aparatit të Ministrisë së Brendshme.

Struktura dhe organika e re, në përmbajtjen e tyre, kanë të evidentuara në mënyrë të qartë, pozicionet e punës për funksionarët politikë të ministrisë, pozicionet e punës ndaj të cilëve zbatohet ligji për nëpunësin civil, si dhe, pozicionet e punës që kryejnë funksione administrative. Struktura e re ka filluar të zbatohet në muajin dhjetor 2017, pasi kanë përfunduar të gjitha veprimet administrative për sistemimin e punonjësve ekzistues në strukturën e re.

Më poshtë po analizojmë strukturën me të cilën ka funksionuar institucioni deri në momentin e fillimit të efekteve të strukturës së re, si dhe strukturën e re, miratimi i të cilës është shoqëruar me shtim të vendeve të punës dhe ndryshim apo ristrukturim të vendeve ekzistuese.

- Struktura e miratuar me urdhrin nr. 70, datë 7.5.2015 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punëve të Brendshme”, e ndryshuar, (ndryshuar me urdhrin nr. 98, dt. 1.7.2015 të Kryeministrit; ndryshuar me urdhrin nr. 39, dt. 11.3.2016 të Kryeministrit).

Në bazë të kësaj strukture, aparati i Ministrisë së Punëve të Brendshme **kishte 177 pozicione pune gjithsej**, të organizuara në këtë mënyrë:

- ✓ **16 pozicione pune, funksionarë politikë**, (1 ministër + 3 zëvendësministër + 1 drejtor kabineti + 6 këshilltarë + 5 sekretare).
- ✓ **144 pozicione pune, të shërbimit civil**, (1 sekretar i përgjithshëm + 5 drejtorë të përgjithshëm + 17 drejtor drejtorie + 15 përgjegjës sektori + 13 koordinatorë + 5 inspektorë + 88 specialistë).
- ✓ **12 pozicione pune, punonjës administrativë**, (1 sekretare + 2 arkivist/protokollist + 1 arkivist + 1 magazinier + 5 pastrues + 2 punëtor).
- ✓ **5 pozicione pune me Gradë**, (1 drejtor drejtorie + 1 përgjegjës + 3 specialistë).
- Struktura dhe organika e miratuar me urdhrin nr. 162, datë 5.10.2017 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme”.

Në bazë të kësaj strukture për aparatën e Ministrisë së Brendshme **janë miratuar 215 pozicione pune gjithsej**, të organizuara në këtë mënyrë:

- ✓ **18 pozicione pune, funksionarë politikë**, (1 ministër + 4 zëvendësministër + 1 drejtor kabineti + 6 këshilltarë + 6 sekretare).
- ✓ **178 pozicione pune, të shërbimit civil**, (1 sekretar i përgjithshëm + 6 drejtorë të përgjithshëm + 20 drejtor drejtorie + 24 përgjegjës sektori + 11 koordinatorë + 116 specialistë).
- ✓ **12 pozicione pune, punonjës administrativë**, (1 sekretare + 2 arkivist/protokollist + 1 arkivist + 1 magazinier + 5 pastrues + 2 punëtor mirëmbajtje).

✓ **7 pozicione pune me Gradë**, (1 përgjegjës sektori + 6 specialistë).

Duke krahasuar strukturën e vjetër me strukturën e re, konstatohet se *numri i përgjithshëm i vendeve të punës ishte 177 dhe është bërë 215*, ndërsa *numri i pozicioneve të shërbimit civil ishte 144 dhe është bërë 178*, pra janë shtuar 34 pozicione të shërbimit civil.

Konstatohet se, për shkak të miratimit të strukturës së re, pozicionet e shërbimit civil kanë pësuar ndryshime jo vetëm në numër (*janë shtuar 34 vende të reja*) por, ka ndryshuar edhe mënyra e organizimit të njërive organizative pjesë përbërëse e institucionit. Sipas strukturës së re institucioni ka 6 drejtori të përgjithshme, 20 drejtori dhe 24 sektorë ndërsa struktura e vjetër kishte 5 drejtori të përgjithshme, 17 drejtori dhe 15 sektorë. Gjithashtu, pozicionet e punës me emërtesën “*Koordinator*” janë pakësuar pasi ishin 13 dhe aktualisht janë 11, po kështu nuk janë parashikuar pozicione pune me emërtesën “*Inspektor*”.

Mënyra e organizimit të pozicioneve të shërbimit civil sipas strukturës së re krahasuar me strukturën e vjetër, paraqitet sipas tabelës, si më poshtë:

Pozicionet e shërbimit civil sipas emërtesës	Numri i pozicioneve të punës (sipas strukturës së vjetër)	Numri i pozicioneve të punës (sipas strukturës së re)
Pozicione pjesë e TND (<i>sekretar i përgjithshëm, drejtor i përgjithshëm</i>)	6	7
Drejtor drejtorie	17	20
Përgjegjës sektori	15	24
Koordinatorë	13	11
Inspektorë	5	0
Specialistë	88	116
Nëpunës civilë gjithsej	144	178

Konstatim:

Aktualisht, vendimi nr. 502, datë 13.9.2017, i Këshillit të Ministrave , “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme*”, ka ndryshuar. Më konkretisht, me vendimin nr. 10, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave “*Për një ndryshim në vendimin nr. 502, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave , “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme*”, është shfuqizuar shkronja “e”, e pikës 3, e VKM nr. 502, dt. 13.9.2017, ku si pjesë të fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Brendshme përcaktohej: “planifikimi dhe përballimi i emergjencave civile”.

Në kuadër të këtij ndryshimi, njësia organizative me emërtesën “*Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile*”, i shkëputet strukturës dhe organikës së

Ministrisë së Ministrisë së Brendshme. Por, pavarësisht nga ndryshimet e miratuara në lidhje me fushën e përgjegjësive të institucionit, aktualisht institucioni është i organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar me urdhrin nr. 162, datë 5.10.2017 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme”, të cilës nuk i është bërë asnjë ndryshim.

Konkluzion:

- Konkludohet se aparati i Ministrisë së Brendshme ka kaluar në proces ristrukturimi, në kushtet kur konstatohet plotësimi i kërkesave ligjore për të patur një proces të tillë: **a)** janë shtuar vendet e punës pjesë e shërbimit civil; **b)** janë ristrukturuar vendet e punës ekzistuese; **c)** për kryerjen e funksioneve administrative të institucionit është bërë e nevojshme një rishpërndarje e burimeve njerëzore.

II. Procedurat e realizuara për sistemimin e nëpunësve civilë në strukturën dhe organikën e re të institucionit

Nga trajtimi i dokumentacionit të administruar rezulton se, pas hyrjes në fuqi të urdhrin nr. 162, datë 5.10.2017 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme”, njësia përgjegjëse DAP, Sekretari i Përgjithshëm dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit, si dhe nëpunësit përgjegjës të ngarkuar me detyra specifike gjatë procesit të ristrukturimit, kanë nisur kryerjen e procedurave të domosdoshme administrative të parashikuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, të cilat rregullojnë në mënyrë të shprehur procesin e ristrukturimit.

Konstatohet se, menjëhere pas miratimit nga Kryeministri të strukturës dhe organikës së re, njësia përgjegjëse DAP, ka njoftuar individualisht, në mënyrë shkresore të gjithë nëpunësit civil të aparatit të ish Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në këtë rast njësia përgjegjëse ka vepruar në përputhje me përcaktime e pikës 1, të nenit 41, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Nëpunësi civil ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedimi administrativ dhe për çdo vendim përfundimtar që ka të bëjë me marrëdhëniet e tij të shërbimit civil”.

Më pas, është vepruar për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, i cili ka shqyrtuar mundësinë e ripozicionimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, e më tej, njësia përgjegjëse DAP, ka kryer procedurat administrative për konfirmimin e

propozimeve të paraqitura nga komisioni si dhe njoftimin e vendimit të transferimit nëpunësve përkatës.

Në mënyrë më të detajuar konstatojmë si më poshtë:

II.a Krijimi i Komisionit të Ristrukturimit

Për të verifikuar procedurat e ndjekura në kuadër të ristrukturimit, u kërkua nga njëسيا e burimeve njerëzore e institucionit tërësia e materialeve shkresore të cilat dokumentojnë realizimin e këtij procesi. Nga trajtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe vlerësimit të tij në raport me ligjin vërejmë se:

Pas hyrjes në fuqi të strukturës dhe organikës së re, Departamenti i Administratës Publike, me urdhrin nr. 100/1, datë 10.10.2017, “Për krijimin e komisionit të ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme”, ka krijuar komisionin e ristrukturimit të përbërë nga:

- ******, Përgjegjëse e Sektorit të Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Politikave të Rekrutimit të Administratës Publike, në Departamentin e Administratës Publike - kryetar.
- ******, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Rendin dhe Sigurinë Publike, në Ministrinë e Brendshme - anëtar.
(***** me shkresën nr. 7453, datë 5.10.2017 të Ministrit të Brendshëm, duke qenë se pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm ishte vend vakant, i janë ngarkuar kompetencat e këtij pozicion, deri në plotësimin e tij sipas procedurave të ligjit për nëpunësin civil).
- ******, Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Strategjik dhe Analizës, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Integritimit - anëtar.
(Drejtori i Drejtorisë të Shërbimeve të Brendshme që është njëسيا përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, ***** ka filluar lejen e lindjes që nga data 4.9.2017).

Konkluzion:

- Komisioni i ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme është ngritur në përputhje me pikën 3, të nenit 50 të ligjit ku përcaktohet se “Në çdo rast mbyllje apo ristrukturimi krijohet një komision ristrukturimi. ...”.

- Komisioni i ristrukturimit, është krijuar nga njësia përgjegjëse, në përputhje me pikën 16, të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, ku përcaktohet se “Në rastet e mbylljes apo ristrukturimit, njësia përgjegjëse krijon një komision ristrukturimi ...”.
- Numri i anëtarëve të komisionit është në përputhje me pikën 17, të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, ku parashikohet se “Komisioni përbëhet nga tre anëtarë dhe krijohet nga njësia përgjegjëse sipas rastit”.
- Në caktimin e drejtuesit dhe anëtarëve të komisionit, janë respektuar parashikimet e pikës 5, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe rregullat e vendosura nga udhëzimi nr. 1, datë 1.3.2016, i Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

II.b Shqyrtimi i mundësisë për sistemimin e të gjithë nëpunësve civilë në strukturën e re

Në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe rregullave të parashikuara në pikat nga 4 deri në 17, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016 të Departamentit të Administratës Publike “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, i ndryshuar, për ripozicionimin e çdo nëpunësi civil në strukturën e re, komisioni i ristrukturimit (Komisioni), ka ndjekur hapat si më poshtë:

Së pari, Komisioni ka administruar dhe shqyrtuar strukturën ekzistuese dhe strukturën e re të institucionit, duke evidentuar pozicionet e punës të mbetura apo të ristrukturuara, pozicionet e reja të krijuara rishtazi, si dhe pozicionet e punës që suprimoheshin në kuadër të miratimit të strukturës së re. (Analizën dhe ndryshimet e strukturës së re të krahasuar me strukturën e vjetër, i kemi paraqitur në mënyrë të hollësishme në pikën I, të këtij materiali, me titull “Struktura organizative e Ministrisë së Brendshme para dhe pas procesit të ristrukturimit”).

Nga shqyrtimi i strukturës dhe organikës së vjetër të institucionit (struktura dhe organika e miratuar me urdhrin nr. 70, datë 7.5.2015 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punëve të Brendshme”, e ndryshuar), si dhe

i listëprezencës dhe listëpagesës së muajit nëntor 2017, (deri në këtë moment është zbatuar struktura dhe organika e vjetër), rezulton se struktura dhe organika ekzistuese kishte **144** pozicione të shërbimit civil, ku:

- **123 pozicione të shërbimit civil**, ishin të plotësuar;
- **21 pozicione të shërbimit civil**, ishin vende vakante.

Konstatohet se, nga **123** nëpunës civil që kishte institucioni, **5** prej tyre ishin nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese, anëtarë të TND-së. Ky grup nëpunësish nuk është trajtuar nga Komisioni pasi, për menaxhimin dhe lëvizjen e tyre zbatohen përcaktimet e nenit 30, pika 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe rregullat e kreut VII, me titull “Caktimi i anëtarit të TND-së në një pozicion të rregullt”, pika 1, 2 e 3, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar. Pra, nëpunësit e nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND-së, nuk trajtohen nga Komisioni i ristrukturimit.

Në kushte të tilla, Komisioni ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit **për 118 nëpunës civilë** (14 drejtor drejtorie + 13 përgjegjës sektori + 11 koordinatorë + 4 inspektorë + 76 specialistë).

Së dyti, Komisioni ka verifikuar përshkrimet e punës për pozicionet e krijuara, të mbetura apo të ristrukturuara.

Rregullat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, miratimin dhe bërjen efektive të strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore, janë të përcaktuara në pikat nga 30 deri në 40, të vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”. Ndër të tjera këto rregulla parashikojnë se përshkrimet e punës për çdo pozicion pune të strukturës së re, i bashkëlidhen propozimit për ndryshimin e strukturës, që institucioni i dërgon DAP. Më konkretisht, në shkronjën “c”, të pikës 33, është parashikuar se:

“Institucioni, i cili propozon ndryshimin e strukturës, dërgon në Departamentin e Administratës Publike të dhënat e mëposhtme:

(shkronja c) “Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi”. ...

Detyrimin për hartimin e përshkrimeve të punës në momentin kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, e parashikon edhe vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Në mënyrë të shprehur pika 14, e kreut IV, të këtij akti nënligjor parashikon:

“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.

Në respektim të rregullave të vendosura nga aktet nënligjore si më sipër, subjektet e ngarkuara me përgjegjësinë e hartimit, miratimit e administrimit të përshkrimeve të punës siç janë: njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, analisti i punës, eprori direkt i pozicionit respektiv të punës, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe njësia përgjegjëse, duhet të hartonin përshkrime të reja punës, për të gjitha pozicionet e shërbimit civil të strukturës së re.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, fillimisht ka përgatitur një ekstrakt të përshkrimeve të punës, si dhe kërkesat e posaçme për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi për ndryshimin e organizimit të brendshëm të institucionit, të cilin bashkë me relacionin propozues për ndryshimin e strukturës organike ia ka dërguar Departamentit të Administratës Publike. Më pas, këto materiale i janë vënë në dispozicion Komisionit të Ristrukturimit, i cili nga verifikimi i tyre ka evidentuar kriteret e veçanta për çdo pozicion pune të shërbimit civil.

Pas marrjes së konfirmimit nga Departamenti i Administratës Publike, lidhur me propozimet për ripozicionimin e të gjithë punonjësve në strukturën e re, njësia e burimeve njerëzore ka finalizuar procesin e miratimit të përshkrimeve të reja të punës.

Në momentin e kryerjes së verifikimit në institucion, u konstatua se përshkrimet e punës janë të hartuara sipas formatit që parashikon lidhja 4, bashkëlidhur vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Përshkrimet e reja të punës janë të miratuara nga nëpunësi civil përkatës, eprori direkt dhe Sekretari i përgjithshëm sipas përcaktimeve të kreut IV, “Procedura dhe formati i përshkrimit të punës”, i VKM nr. 142, dt. 12.3.2014, i ndryshuar, i cituar si më sipër.

Së treti, Komisioni ka shqyrtuar për çdo nëpunës, plotësimin e kërkesave specifike të pozicionit të lirë të së njëjtës kategori, brenda aparatit të Ministrisë së Brendshme, që në këtë rast është i njëjti institucion, ku nëpunësi civil ishte i emëruar.

Sjellim në vëmendje se, në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së re të Ministrisë së Brendshme, pas miratimit të përbërjes së qeversë së re, (*dekretuar me Dekretin nr. 10604, dt. 10.9.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë*), kjo ministri kaloi në proces riorganizimi por nuk pati shkrirje, bashkim apo ndarje të funksioneve me ndonjë institucion tjetër. Në kushte të tilla, komisioni i ristrukturimit për të mundësuar sistemimin e nëpunësve ekzistues ka verifikuar plotësimin e kërkesave specifike të pozicionit të lirë të së njëjtës kategori sipas precedencës së përcaktuar në shkronjën “a”, “c” e “ç”, të pikës 2, të nenit 50 të ligjit, ku përcaktohet se transferimi në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, për shkak të ristrukturimit të institucionit, bëhet me precedencë, sipas kësaj renditje:

- a) *“në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar;*
- b) *në institucionin, me të cilin institucioni është shkrirë apo bashkuar, në një nga institucionet, në të cilat institucioni është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi;*
- c) *Në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar;*
- d) *Në një institucion tjetër të shërbimit civil”.*

Më tej, pika 3 e nenit 50 të ligjit, përcakton se:

“... Komisioni shqyrton mundësitë e sitemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike. ...”.

Në mbështetje të nenit 50 të ligjit, ka dalë vendimi nr. 125, datë 17.2.2016, i Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil”*. Ky akt nënligjor, në pikën 18, të kreut II, *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, përcakton kriteret në të cilat mbështetet komisioni i ristrukturimit në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit. Ndërsa, në pikën 19, përcaktohen kriteret, në të cilat komisioni mbështet vendimmarrjen për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.

Më konkretisht dispozitat e aktit nënligjor, si për sipër përcaktojnë:

(Pika 18) *“Komisioni i ristrukturimit në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet në kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe të dhënata e nëpunësve civil, vendet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit. Vendimi është individual për çdo nëpunës civil”.*

(Pika 19) “Komisioni i ristrukturimit në vendimin e tij për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet mbi këto kritere:

- a) Vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil;
- b) Vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civil;
- c) Vlerësimin e fundit që ka pasur nëpunësi në testimin për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”.

Në zbatim të detyrave të përcaktuar nga dispozitat ligjore e nënligjore si më sipër, **për 118 nëpunësit civil që u përfshinë në procedurën e ristrukturimit**, Komisioni ka verifikuar dosjen e personelit me qëllim verifikimin e plotësisht të kërkesave të posaçme për nivelin e diplomës së arsimit të lartë, profilin e arsimit të lartë, kualifikimet, përvojën në punë, vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe gjendjen shëndetësore të provuar me vërtetimin mjekësor përkatës dhe nëpunësit me largësi vendbanimi më shumë se 45 km nga institucioni, pasi këto dy të fundit, janë të përmendura nga pika 21, e VKM nr. 125, dt. 17.2.2016, si arsye e nëpunësit për të refuzuar vendimin e Komisionit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, nëpunësi i ngarkuar me detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm i ka vënë në dispozicion Komisionit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm si: një ekstrakt të përshkrimit të punës, në të cilin është pasqyruar emërtesa e pozicionit përkatës sipas strukturës së re, si dhe kërkesat e posaçme që duhet të plotësojë nëpunësi civil në pritje për transferim si niveli i diplomës, profili i arsimit të lartë, kualifikimet, trajnimet e ndryshme, njohuri të gjuhës së huaj etj; dosjet individuale të nëpunësve të cilat përmbajnë të dhënat profesionale për çdo nëpunës civil, si dhe çdo të dhënë tjetër, lidhur me marrëdhëniet e punës. Komisioni në punën e tij është asistuar nga njësia e personelit e institucionit, e cila ka kryer detyrat e Sekretarisë Teknike.

II. c Transferimi i përhershëm i nëpunësve civil, në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.

Në përfundim të veprimeve administrative të kryera për verifikimin e kërkesave të posaçme të parashikuara për çdo pozicion të shërbimit civil si dhe verifikimit të të dhënave individuale të nëpunësve civilë në pritje për transferim, Komisioni ka vendosur të propozojë si më poshtë:

- **Për 113 nëpunës**, është propozuar transferimi i përhershëm në strukturën e re të aparatit të Ministrisë së Brendshme, që në këtë rast është institucioni ku nëpunësi ishte i emëruar, (është vepruar sipas precedencës së përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 50 të ligjit).

Vendimet individuale të Komisionit për çdo nëpunës civil janë pasqyruar në shkresat:

- ✓ Shkresa nr. 6726 prot., datë 24.11.2017 “*Vendim i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme*”. (Në këtë material, Komisioni ka propozuar për 110 nëpunës civilë ekzistues, mundësinë e transferimit të përhershëm të tyre në strukturën e re të institucionit).
- ✓ Shkresa nr. 6726/112 prot., datë 11.12.2017 “*Vendim i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme*”. (Në këtë material, Komisioni ka propozuar për 3 nëpunës civilë ekzistues, mundësinë e transferimit të përhershëm të tyre në strukturën e re të institucionit).

Nga verifikimi në tërësinë e tyre të këtyre materialeve shkresore rezulton se, në këtë rast nëpunësit janë sistemuar në pozicione të shërbimit civil të të njëjtës kategori. Pra nëpunësit civil të kategorisë së mesme drejtuese janë sistemuar në pozicione të kësaj kategorie, nëpunësit civil të kategorisë së ulët drejtuese janë sistemuar në pozicione të kësaj kategorie dhe nëpunësit e kategorisë ekzekutive janë sistemuar në këtë kategori.

Konstatohet se, në strukturën e re, pozicionet e punës të kategorisë “*ekzekutive*”, klasa “*specialist*” në përbërje të “*Drejtorinë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar*” dhe “*Drejtoria së Arkivit të Sistemit*”, janë kategorizuar në pagë, një nivel më lartë krahasuar me strukturën e vjetër. Në këtë rast, për **3 punonjës**, pozicioni i punës ka qenë dhe është i kategorisë “*ekzekutive*”, klasa “*specialist*”. Pra pavarësisht se struktura e re ka parashikuar një ndryshim në nivelin e pagës, kategoria dhe klasa e pozicionit në shërbimin civil, nuk ka pësuar asnjë ndryshim.

Njësia përgjegjëse DAP, menjëherë pas marrjes së propozimeve nga komisioni i ristrukturimit ka vendosur për transferimin e nëpunësve civilë, vendimi i transferimit iu është njoftuar nëpunësve përkatës duke i marrë secilit, në mënyrë shkresore pëlqimin për transferim (Shkresa e DAP nr. 6726/1 prot., dt. 24.11.2017 dhe nr. 6726/113 prot., dt. 11.12.2017, lënda “*Mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme*”).

- **Për 1 nëpunës**, është propozuar transferimi i përhershëm në institucionin Departamenti i Administratës Publike, (*vendim i Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme nr. 6726/119 prot., datë 8.1.2018*).

Në këtë rast, transferimi i nëpunësit është bërë sipas precedencës së përcaktuar në shkronjën “ç”, pika 2, të nenit 50 të ligjit, ku parashikohet se, nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet një një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori në një institucion tjetër të shërbimit civil. Bëhet fjalë për:

*****, ish “Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik”, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Integritit, Ministria e Punëve të Brendshme, kategoria II-a. Me vendimin nr. 6726/119, datë 8.1.2018 të Komisionit të Ristrukturimit është vendosur transferimi i përhershëm në pozicionin “Specialist në Sektorin e Qeverisjes së Mirë dhe Jetësimit të Prioriteteve”, në Departamentin e Administratës Publike, kategoria III-b.

Konstatohet se, sistemimi i nëpunësit ***** në një pozicion të së njëjtës kategori, në strukturën e re të Ministrisë së Brendshme, ku ai i plotësonte kërkesat specifike, ka qenë i pamundur pasi, sipas strukturës së vjetër ai mbante pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik”, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Integritit. Në strukturën e re pozicioni i tij i punës nuk ekziston më, për shkak se funksionet e njësisë kryesore (funksionet e drejtorisë së përgjithshme), ku bënte pjesë “Drejtoria e Planifikimit Strategjik”, i kanë kaluar Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Rendit, Sigurisë Publike dhe Çështjeve Vendore. Gjithashtu, sistemimi në një pozicion tjetër të kategorisë së mesme drejtuese në institucion, ishte i pamundur pasi nuk plotësonte kërkesat e posaçme për vendin e punës.

Mbështetur në faktet e përmendura si më sipër, Komisioni me vendimin nr. 6726/119, datë 8.1.2018, i ka propozuar njësisë përgjegjëse DAP, transferimin e përhershëm të nëpunësit ***** në pozicionin “Specialist në Sektorin e Qeverisjes së Mirë dhe Jetësimit të Prioriteteve”, në Departamentin e Administratës Publike, kategoria III-b, pozicion ky i një kategorie më të ulët se pozicioni që mbante para ristrukturimit. Në këtë rast, Komisioni i ka marrë nëpunësit mendimin me shkrim, ku rezulton se ai ka dhënë pëlqimin/dakordësinë se e pranon transferimin e përhershëm në një pozicion të një kategorie më të ulët, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit.

Pas marrjes së propozimit nga Komisioni, njësia përgjegjëse me shkresën nr. 6726/120 prot., datë 8.1.2018, e ka miratuar atë, duke ia njoftuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme. Më tej, ka nxjerrë shkresën nr. 6726/121 prot., datë 8.1.2018, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, duke ia njoftuar aktin e transferimit nëpunësit ***** dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme.

Konkluzion:

- Komisioni i Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme, në nxjerrjen e vendimeve individuale, propozim për transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, ka vepruar në mbështetje të përcaktimeve të pikës 1, 2 e 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; shkronjës “a”, të pikës 17, dhe pikës 18, të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për

transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; si dhe pikave nga 8 deri në 17 të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*.

- Njësia përgjegjëse DAP, në nxjerrjen e vendimit përfundimtar për transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, ka vepruar në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; pikës 20 të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*; pikës 18 e 19, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*.

II.d Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, për **4 nëpunës civilë**, Komisioni ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit. Në këtë rast bëhet fjalë për:

*****, ish *“Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit me Prefekturat”*, në ish Ministrinë e Punëve të Brendshme, me vendimin nr. 7398/248, datë 10.1.2018 të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

Sistemimi i nëpunësit ***** në një pozicion të së njëjtës kategori në të cilin ai plotësonte kërkesat specifike ka qenë i pamundur pasi, sipas strukturës së vjetër ai mbante pozicionin *“Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit me Prefekturat”*, në strukturën e re funksionet që kryente ky pozicion i kanë kaluar Sektorit të Prefekturave, në Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe të Funksioneve të Deleguara. Sistemimi në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, brenda strukturës së institucionit, ishte i pamundur pasi, bazuar në të dhënat individuale që përbante dosja e personelit, ai nuk i plotësonte kërkesat e posaçme për vendin e punës. *(Zotëron diplomë DIND, Akademia e Arteve, Koreografi, përvojë pune, në datën 29.1.2014, është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit me Prefekturat)*. Sistemimi në një institucion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, ishte i pamundur pasi, me miratimin e përbërjes së qeverisë së re, 5 ministri të linjës u shkurtuan, *(ishin 16 ministri dhe u miratuan 11 ministri)*. Ky proces u shoqërua me shkurtrim të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të shërbimit civil.

Nga verifikimi i materialeve të administruara rezulton se, nëpunësit në fjalë i është ofruar mundësia e sistemimit në një pozicion të një kategorie më të ulët, siç është pozicioni “Përgjegjës i Sektorit të Prefekturave”, në Drejtorinë e Çështjeve Vendore dhe të Funksioneve të Deleguara, në Ministrinë e Brendshme. Por në këtë rast, nëpunësi nuk e ka dhënë pëlqimin apo dakordësinë e tij.

Gjithashtu sistemimi në institucionet e shërbimit civil në varësi të ministrisë ka qenë i pamundur, për arsye se kategoria e pagës e parashikuar për pozicionet e shërbimit civil në institucionet e varësisë është më e ulët se ajo e miratuar për ministrinë përgjegjëse.

Për këto arsye është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, duke i njohur nëpunësit të gjitha të drejtat e përcaktuara në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, siç është e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë.

Bazuar në vendimin nr. 7398/243, datë 10.1.2018 të Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme, njësia e burimeve njerëzore e institucionit ka nxjerrë vendimin nr. 7398/247, datë 10.1.2018, “Për lirim nga shërbimi civil”, me të cilin ka deklaruar lirim nga shërbimi civil të nëpunësit civil *****. (Në momentin e kryerjes së verifikimit në institucion rezulton se, *****, me urdhrin nr. 88, datë 31.1.2018, të Ministrisë së Brendshme, është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore).

*****, me detyrë ish “Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm”, në ish Ministrinë e Punëve të Brendshme, me vendimin nr. 7398/244, datë 10.1.2018, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

Sistemimi i nëpunësit *****, në një pozicion të së njëjtës kategori në të cilin ai plotësonte kërkesat specifike ka qenë i pamundur pasi, sipas strukturës së vjetër ai mbante pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm”. Në strukturën e re kjo drejtori nuk ekziston më pasi është suprimuar. Sistemimi në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, brenda strukturës së institucionit, ishte i pamundur pasi, bazuar në të dhënat që përmbante dosja e personelit, nuk i plotësonte kërkesat specifike për vendin e punës. (Zotëron diplomë Bachelor në Sociologji dhe diplomë Master Shkencor në Drejtë Civile, përvojë pune në dt. 27.1.2014, është emëruar “Inspektor”, në dt. 17.6.2016, është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm).

Sistemimi në një institucion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, ishte i pamundur pasi, me miratimin e përbërjes së qeverisë së re, 5 ministri të linjës u

shkurtuan, (*ishin 16 ministri dhe u miratuan 11 ministri*). Ky proces u shoqërua me shkurtim të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të shërbimit civil.

Gjithashtu sistemimi në institucionet e shërbimit civil në varësi të ministrisë ka qenë i pamundur, për arsye se kategoria e pagës e parashikuar për pozicionet e shërbimit civil në institucionet e varësisë është më e ulët se ajo e miratuar për ministrinë përgjegjëse.

Për këto arsye, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil duke i njohur të drejtat e përcaktuara në pikën 7, të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, siç është e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë.

Bazuar në vendimin nr. 7398/244, datë 10.1.2018 të Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme, njësia e burimeve njerëzore e institucionit ka nxjerrë vendimin nr. 7398/248, datë 10.1.2018, “*Për lirim nga shërbimi civil*”, me të cilin ka deklaruar lirim nga shërbimi civil të nëpunësit civil *****.

*****, ish “*Specialist për TI, në Drejtorinë e Komunikimit dhe TI*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në ish Ministrinë e Punëve të Brendshme, me vendimin nr. 7398/245, datë 10.1.2018, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

*****, ish “*Specialist për TI, në Drejtorinë e Komunikimit dhe TI*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në ish Ministrinë e Punëve të Brendshme, me vendimin nr. 7398/246, datë 10.1.2018, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

Sistemimi i nëpunësve ***** dhe ***** në një pozicion të së njëjtës kategori në të cilin ata plotësonin kërkesat specifike ka qenë i pamundur pasi, sipas strukturës së vjetër ata mbanin pozicionin “*Specialist për TI në Drejtorinë e Komunikimit dhe TI*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në ish Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në strukturën dhe organikën e re të miratuar për Ministrinë e Brendshme si dhe ministritë e tjera të linjës nuk ekziston më asnjë njësi organizative e dedikuar për kryerjen e funksioneve të menaxhimit TIK. Realizimi i këtyre funksioneve për institucionin e Ministrisë së Brendshme dhe ministritë e tjera të linjës, do të bëhet nga një njësi organizative pjesë e strukturës dhe organikës së re të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të miratuar me urdhrin nr. 177, datë 10.10.2017, institucion i cili nuk është pjesë e shërbimit civil.

Në kushte të tilla ku, në organikën e Ministrisë së Brendshme dhe të ministrive të tjera të linjës, janë shkurtuar pozicionet e punës të dedikuara për kryerjen e funksioneve të

menaxhimit TIK, për nëpunësit që mbanin këto pozicione pune, Komisioni, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

Bazuar në vendimin nr. 7398/242, datë 10.1.2018, të Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme, njësia e burimeve njerëzore e institucionit ka nxjerrë vendimin nr. 7398/245, datë 10.1.2018, “Për lirim nga shërbimi civil”, me të cilin ka deklaruar lirim nga shërbimi civil të nëpunësit civil *****.

Bazuar në vendimin nr. 7398/241, datë 10.1.2018, të Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme, njësia e burimeve njerëzore e institucionit ka nxjerrë vendimin nr. 7398/246, datë 10.1.2018, “Për lirim nga shërbimi civil”, me të cilin ka deklaruar lirim nga shërbimi civil të nëpunësit *****.

Duke analizuar përmbajtjen e vendimit të Komisionit të Ristrukturimit për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, si dhe vendimin e njësisë së burimeve njerëzore për deklarimin e lirit nga shërbimi civil, për nëpunësit ***** dhe ***** , konstatohet se në këto akte nuk janë parashikuar të drejtat e përcaktuara në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, siç është e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë. Por kjo mangësi është rregulluar me akte të xjerra më pas nga njësia e burimeve njerëzore. (Në momentin e kryerjes së verifikimit në institucion rezultoi se ***** dhe ***** , në datën 8.1.2018, kanë nënshkruar kontratë individuale pune me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSH), për punësimin në pozicionin “Specialist në Sektorin e IT, në Ministrinë e Brendshme pranë Drejtorisë së Menaxhimit TIK për Ministrinë e Linjës, për një afat kohor të pacaktuar).

Konstatim:

Nëpunësja, ***** , me shkresën nr. 7726, datë 7.12.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “Specialist për TI, në Drejtorinë e Komunikimit dhe TI”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse, në ish Ministrinë e Punëve të Brendshme. Periudha e provës që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit ka përfunduar në datën 7.12.2017. Me vendimin nr. 9211/1 prot., datë 7.12.2017 të Drejtorit të Drejtorisë së Programeve dhe Jetësimit të Prioriteteve, është konfirmuar si nëpunës civil. Në momentin e kryerjes së verifikimit, njësia përgjegjëse DAP nuk e ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit sipas përcaktimeve të pikës 13, kreu VI, i vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Në lidhje me dhënien e dëmshpërblimit, në përputhje me vjetërsinë në punë:

- Për nëpunësin *****, me shkresën nr. 544 prot., datë 22.1.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, është përcaktuar që në përputhje me eksperiencën e punës si nëpunës civil, mbi 9 vjet, t'i paguhet paga e 12 muajve.
- Për nëpunësit *****, ***** dhe *****, me shkresën nr. 545/1 prot., datë 7.3.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, i është kërkuar njësisë përgjegjëse që të sqarojë masën e përfitimit të dëmshpërblimit për këta nëpunës.

II.e Raste te refuzimit të vendimit të transferimit si dhe të ankimimit në rrugë administrative dhe gjyqësore të vendimit të lirimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.

Me qëllim bërjen efektive të strukturës dhe organikës së re të institucionit Ministria e Brendshme, Komisioni i Ristrukturimit, njësia përgjegjëse DAP dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, kanë kryer një sërë veprimesh administrative të cilat janë përshkruar në mënyrë të hollësishme në përmbajtjen e këtij relacioni. Ky proces është përmbyllur me nxjerrjen e akteve përkatëse siç janë:

- vendimet propozuese të Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori;
- vendimet e transferimit të nxjerra nga njësia përgjegjëse, e cila ka miratuar propozimet e bëra nga Komisioni për ripozicionimin e nëpunësve civilë në strukturën e re;
- vendimet e Komisionit të Ristrukturimit për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të pamundësisë së transferimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit; si dhe,
- vendimet i njësisë së burimeve njerëzore të institucionit për deklarimin e lirimit nga shërbimi civil si rezultat i mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.

Aktet administrative të nxjerra në një rast të tillë (*akti i transferimit të përhershëm si dhe akti i deklarimit të lirimit nga shërbimi civil*), janë akte që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e shërbimit civil, të nëpunësit civil.

Në një rast të tillë neni 41 i ligjit ku parashikohet e drejta e informimit dhe ankimit të nëpunësit civil parashikon:

“Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi, që i cënon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme në marrëdhënien në shërbimin civil”.

Më tej, vendimi nr. 125, datë 17.2.2016 i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil”, në kreun II, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, pikat 20, 21 e 35 parashikojnë:

(pika 20) “Njësia përgjegjëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga komisioni i ristrukturimit, vendos për transferimin e nëpunësit civil, njofton nëpunësin civil për vendimin dhe merr mendimin e tij me shkrim. Nëpunësi civil duhet të japë mendimin e tij me shkrim, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit”.

(pika 21) “Nëpunësi civil ka të drejtë të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësia përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin, vetëm në rast se:

- a) Gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;
- b) Vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil”.

(pika 35, dispozitat e fundit) “Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative dhe gjyqësore sipas rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative dhe legjislacioni në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit, rezulton se në lidhje me aktet e transferimit në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, të gjithë nëpunësit (**II3**) e kanë pranuar transferimin e përhershëm. Në këtë rast, secili nëpunës, në mënyrë individuale, me shkresë nëpërmjet zyrës së protokollit të institucionit, në datën 11.12.2017, i ka përcjellë njësisë përgjegjëse DAP mendimin se është dakord me transferimin.

Gjithashtu edhe nëpunësi *****, i cili është transferuar në Departamentin e Administratës Publike, në një pozicion të një kategorie më të ulët se pozicioni që mbante para ristrukturimit, ka dhënë mendimin e tij me shkrim duke e pranuar pozicionin e punës në të cilin është transferuar.

Bazuar në faktet e përmendura si më sipër, konkludojmë se në asnjë rast nëpunësit e përfshirë në procedurat e ristrukturimit nuk e kanë refuzuar transferimin për shkak të mbylljes apo ristrukturimit.

Konstatohet se edhe nëpunësit *****, *****, ***** dhe *****, për të cilët është deklaruar lirimi nga shërbimi civil si rezultat i mbylljes

apo ristrukturimit të institucionit, nuk janë ankuar në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative.

Pra, lidhur me veprimet administrative të kryera në kuadër të realizimit të procedurave të ristrukturimit të institucionit Ministria e Brendshme nuk ka patur asnjë ankesë.

III. Respektimi i afateve gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit nga Komisioni i Ristrukturimit dhe Departamenti i Administratës Publike

Një moment tjetër i mbikëqyrjes së procesit të ristrukturimit të aplikuar pranë Ministrisë së Brendshme është verifikimi i afateve të përcaktuara në legjislacionin specifik që rregullon këtë aspekt.

Si rregull, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, në momentin e miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, njofton individualisht nëpunësit për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit. Efektet financiare për nëpunësit që do të transferohen apo do t'Û përfundojë marrëdhënia e punësimit, fillojnë jo më shpejt se 1 (një) muaj nga momenti i njoftimit (pika 15 e kreut II, të VKM nr. 125, dt. 17.2.2016). Rezulton se ky afat është respektuar nga Departamenti i Administratës Publike.

Më tej, është parashikuar se, nëpunësi më i lartë civil i institucionit në ristrukturim, jo më vonë se 2 ditë pas hyrjes në fuqi të aktit që ka miratuar ristrukturimin, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit. Njësia përgjegjëse (DAP), brenda 2 ditëve nga marrja e kërkesës krijon Komisionin e Ristrukturimit (sipas përcaktimeve të pikave 1, 1/1 e 2, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike).

Pasi krijohet nga njësia përgjegjëse, Komisioni Ristrukturimit brenda 15 ditëve, nga momenti i krijimit të tij, i propozon njësisë përgjegjëse (DAP), vendimet mbi transferimin e nëpunësve civil (sipas përcaktimeve të pikës 16, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike).

Në vazhdim, njësia përgjegjëse, brenda 10 ditëve, nga data e marrjes së propozimit për transferimin e nëpunësve civil nga Komisioni i Ristrukturimit, vendos për miratimin e propozimeve në fjalë, ose kthimin e akteve Komisionit në rastet kur vërtetohet parregullsi ligjore, i cili e rishqyrton brenda 5 ditëve (sipas pikës 20, kreu II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe pikës 18, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP).

Në këtë rast, aktet nënligjore kanë parashikuar edhe njoftimin e vendimit të transferimit të nëpunësit civil që transferohet dhe marrjen e mendimit të tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit; të drejtën e nëpunësit që të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësi përgjegjëse brenda 5 ditëve dhe pas kësaj rikthimin e akteve për rivlerësim Komisionit, i cili duhet të japë mendimin e tij brenda 5 ditëve (sipas pikës 20 e 21, të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe pikës 19, 20 e 21, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të DAP).

Në këto rrethana, nëse do të aplikoheshin të gjitha fazat e procesit të ristrukturimit, si dhe afatet procedurale të ankimit, si dhe duke llogaritur vonesat në marrjen e njoftimit nga subjektet e përcaktuara në aktet rregullative të përmendura më sipër, atëherë i gjithë ky proces parashikohet që të kryhet brenda një afati kohor që zgjat rreth 60 ditë kalendarike.

Referuar bazës ligjore si më sipër, rezulton se gjatë kryerjes së veprimeve administrative në kuadër të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, duhet të respektohen edhe afatet procedurale të parashikuara për këtë rast.

Për sa është parashtruar në përmbajtjen e këtij Raporti, në rastin e Ministrisë së Brendshme, rezulton se:

- Akti i ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, ka dalë na dt. 5.10.2017, (urdhri nr. 162, datë 5.10.2017, i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme”, në të cilin është përcaktuar se hyn në fuqi menjëherë).
- Komisioni i ristrukturimit është ngritur në datën 10.10.2017 dhe me shkresat nr. 6726 prot., datë 24.11.2017 e nr. 6726/112 prot., datë 11.12.2017, i ka propozuar njësisë përgjegjëse transferimin e 113 nëpunësve në strukturën e re të institucionit; me shkresën nr. 6726/119 prot., datë 8.1.2018, i ka propozuar njësisë përgjegjëse transferimin e 1 nëpunësi në një institucion tjetër të shërbimit civil; me vendimet nr. 7398/248, datë 10.1.2018; nr. 7398/244, datë 10.1.2018; nr. 7398/245, datë 10.1.2018 dhe nr. 7398/246, datë 10.1.2018, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për 4 nëpunës.
- Njësia përgjegjëse DAP me marrjen e propozimit nga komisioni, menjëherë ka nxjerrë vendimet e transferimit të nëpunësve, (shkresat e DAP nr. 6726/1 prot., dt. 24.11.2017 dhe nr. 6726/113 prot., dt. 11.12.2017, “Mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme”).

Pra, procedurat e transferimit të nëpunësve për shkak të mbylljes apo ristrukturimit për 113 nëpunës kanë përfunduar në dt. 11.12.2017, brenda afateve të parashikuara. Ndërsa, në rastin e transferimit të 1 nëpunësi në një institucion tjetër si dhe në rastin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për 4 nëpunës, afatet e parashikuara janë tejkaluar.

Në dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e ristrukturimit, ligjvënësi ka përcaktuar të vendosë afatet procedurale të përmendura më sipër, për të disiplinuar këtë proces me qëllim që procesi të mos zvarritet. Megjithatë, vlen të theksohet se, afati i mësipërm ligjor shërben si një garant në kushtet e zhvillimit të një procesi ristrukturimi në rrethana të zakonshme. Në rastin konkret, për sa është pasqyruar në përmbajtjen e këtij Raporti, rezulton se ndodhemi në kushtet e riorganizimit tërësor të aparatit shtetëror, i cili është shoqëruar me ndryshim të theksuar të mënyrës së funksionimit të ministrive, misionit të tyre si dhe të riformatimit të njësive organizative, fakt që kërkon një periudhë më të gjatë kohore të realizimit të procedurës së ristrukturimit.

Për sa më sipër, grupi i punës vlerëson se, në rastin e Ministrisë së Brendshme, tejkalimi i afateve në realizimin e procedurave për 5 nëpunës, nga Komisioni ka ardhur si rrjedhojë e numrit të lartë të nëpunësve civilë, pozicionet e të cilëve prekeshin me miratimin e strukturës dhe organikës së re të këtij institucioni, si dhe për shkak të ushtrimit të kompetencave ligjore të Departamentit të Administratës Publike për verifikimin e zbatimit të legjislacionit civil gjatë vendimmarrjes së Komisionit të Ristrukturimit, me qëllim garantimin e të drejtave të nëpunësve civilë nëpërmjet një vendimmarrje të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Në rastin konkret vlerësojmë se, aplikimi i procesit të ristrukturimit nga aktorët e caktuar nga ligji është realizuar *brenda afateve* ligjorë, duke përmblyllur këtë proces pa zvarritje.

Konkluzione

Në përfundim të analizës së fakteve si më sipër, arrihet në konkluzionin se, procedurat për krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Brendshme, si dhe veprimet administrative për sistemimin e punonjësve ekzistues në strukturën e re të institucionit, janë të mbështetura në ligj dhe janë kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 50 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kreun II “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*” si dhe udhëzimin nr. 1, datë 1.3.2016 të Departamentit të Administratës Publike “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, i ndryshuar.

*

* *

Këto ishin rrethanat e konstatuara gjatë procesit të monitorimit të procedurave të kryera në kuadër të ristrukturimit të institucionit Ministria e Brendshme, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha